



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 580/1 prot.

Tiranë më 3. 3. 2021

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”, të ndryshuar”.

**KRYEMINISTRISË**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1588 Prot., datë 24.03.2021, me anë të së cilës kërkohet mendimi lidhur me projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”, të ndryshuar”, në vijim gjeni qëndrimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Vlen të theksojmë se përmbajtja e projektvendimit “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”, të ndryshuar”, në tërësi implementon parimet dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Pas analizimit të përmbajtjes së projektvendimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Referuar gërmës “b” të pikës 3, vlerësojmë që togfjalëshi “*përfshirë përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*përfshirë përditësimin, korrigjimin, ndryshimin e informacionit të ruajtur, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe sigurinë dhe konfidencialitetin*”;
- Referuar gërmës “g” të pikës 3, vlerësojmë që pas fjalës “*shkëmbim*” të shtohet fjala “*dhe transmetimit*”;
- Referuar pikës 7, është e nevojshme që të shtohet fjalia me përmbajtje si vijon: “*Afatet e ruajtjes së veprimeve të kryera në bazën e të dhënave përcaktohen në rregulloren e veçantë që miratohet nga AKSHF*”;

- Referuar pikës 14, vlerësojmë se është e nevojshme të përcaktohen “*institucionet e interesuara*” pasi aksesit nuk mund të jetë i pakufizuar.

Me plotësimin e sa më sipër, projektvendimi vlerësohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**  
